



A.nr.137/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurës sipas në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.75/2026, të datës 26.01.2026 dhe ankesës me numër A.nr.137/2026, të datës 04.02.2026, të parashtruar nga ankuesi B.S. nga Rahoveci, të bashkuara sipas Vendimit VK./2026, të datës 06.03.2026, të Kryesuesit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në ankesën e fundit A.nr.137/2026, kundër organit të punësimit: Komuna e Rahovecit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.137/2026, e datës 04.02.2026, e parashtruar nga ankuesi B.S.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, B.S. (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 21.01.2026 përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 26.01.2026 e regjistruar nën shenjë A.nr.75/2026, me pretendimet për klasifikim të pozitës së tij si Specialit, ndërsa, më datë 02.02.2026, po përmes postës ka parashtruar ankesë të re e pranuar më datë 04.02.2026 e regjistruar nën shenjë A.nr.137/2026, kundër Vendimit me numër protokolli 6933, të datës 21.01.2026, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit.

Duke qenë se ankesat kanë objekt të njëjtë ankimore, KPMSHC-ja në kuptim të dispozitave të nenin 84, paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më Vendimin VK./2026, të datës 06.03.2026, të Kryesuesit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është bërë bashkimi procedurave të ankesës A.nr.75/20026 dhe ankesës A.nr.137/2026, e më të cilin vendim më kohë është njoftuar pala ankuese.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës

për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Komuna e Rahovecit, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjell përgjigjen në ankesë si dhe provat materiale ndërlidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorie administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 392/2026, të datës 26.01.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.1147/2025 të KPMSHCK-së; Mendimin Mospajtues A.nr.1145/2025; Emailin e datës 16.12.2025 nga Drejtori i DMZP-së; Emailin e datës 26.11.2025 nga A.Th. për N.Sh, Q.B, A.F, A.K; Diplomën me Nr. 804 të ankuesit; Zarfin e datës 21.01.2026; Ankesën me numër protokolli 599/2026, të datës 04.02.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 6933, të datës 21.01.2026, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit; Zarfin e datës 02.02.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.02.2026 dhe 09.02.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 13.02.2026; Formularin e përshkrimit të punës për pozitën Zyrtar për Bujqësi; AKT Emërimit me Nr. 4720/2024 i datës 17.09.2024; Kërkesën për klasifikim të pozitës si specialist e datës 21.01.2026 nga ankuesi; Vendimin VK./2026, të datës 06.03.2026, të Kryesuesit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për bashkimin e ankesave të ankuesit; Konkursin RN00014608 për pozitën Zyrtar për Bujqësi.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e a ***është e parakohshme sepse:***

I. Vlerësimi gjendjes së fakteve:

- Ankuesi sipas Akt-it të emërimit me Nr. 4720/2024, të datës 17.09.2024, ushtron pozitën e punës *Zyrtar për Bujqësi* në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit.
- Ankuesi duke u thirrur në Vendimin A.nr.1147/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.01.2026, ka parashtruar kërkesë tek Zyra e Kryetarit dhe Zyra e Personelit, për klasifikimin e pozitës së tij si Specialist.
- Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Rahovecit, më datë 22.01.2026, ka nxjerr Vendimin me numër protokolli 6933, me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesit, me arsyetimin se sipas opinionit të DMZP-së, gjatë përcaktimit të pozitave në kategori dhe klasën specialist është përcaktuar qartë se nëpunësve civil ekzistues nuk mund t'u ndryshohet kategoria aktuale të kategorinë e Specialistëve përveç rasteve kur ata tashmë janë duke u paguar sipas kësaj kategorie, dhe për rrjedhojë Komuna nuk ka bazë ligjore për ta përfshirë pozitën e ankueses në Specialit sipas Rregullores për Organizmin e Brendshëm.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se pozita të cilën e shtron sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë i plotëson kushtet për t'u kategorizuar si pozitë e Specialistit dhe këtu sipas vendimit të kontestuar me ankesë është vepruar në

kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse dispozita është akt më i lartë se një opinion i DMZP-së. Kërkon që ankesa të aprovohet.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit iu referua bazës ligjore si me poshtë:

I. Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik

-Neni, 2 paragrafi 1: *''1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj''*,

-Neni 14, paragrafi 3, të: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik.*

II. Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik

-Neni 38, paragrafi 2: *: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtorin/i në përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatorë, drejtorin/in ekzekutiv dhe zëvendësdrejtorin/in e një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtores/it të departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqëses/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.4. Kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike; dhe 2.5. Kategoria profesionale që përfshin zyrtarët profesional''*

II. Rregullorja (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil:

-Neni 8: *Kategoria e specialistëve është kategoria përgjegjëse për kryerjen e detyrave të veçanta profesionale që kërkojnë përgatitje specifike sipas fushave të përcaktuara në Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje, (më Shtojcën Nr.1/4 të kësaj rregulloreje tek përshkrimi për klasën e specialistëve është përcaktuara: "Në këtë klasë vendosen pozitat e nivelit të lartë profesional me përgatitje specifike, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale. Mbajtësit e këtyre pozitave kryejnë një sërë detyrash të natyrës komplekse ose specifike në mënyrë individuale ose si udhëheqës ose anëtar i një ekipi. Mbajtësit e këtyre pozitave punojnë të pavarur dhe pa mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave", kurse si kushte formale për këtë kategori janë paraparë: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushat e inxhinierisë, planifikim hapësinor, arkitekturë, urbanizëm, gjeodezi, kimi, fizikë, matematikë, biologji, mjekësi, farmaci, biokimi, ekologji, pylltari, bujqësi, veterinari, gjeografi, **ambient**, astronomi, astrofizikë, pa përfshirë drejtime arsimore.*

-Neni 34: Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

Rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, kurse klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. Andaj, mbi bazën e këtij përcaktimi Kolegji sjell në vëmendje faktin se pozita specialist është vendosur si kategori e veçantë në kuadër të shërbimit civil, në kuadër të së cilës hynë pozita që kërkohet përgatitje specifike sipas fushave të përcaktuara më Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, andaj, edhe institucionet bartin detyrimin që edhe klasifikimin e pozitave të bëjnë në pajtim me këto kërkesa ligjore, rrjedhimisht, kategorizimi i një pozitë behët ne varësi të faktorëve dhe karakteristikave të përshkrimit të detyrave të punës së një pozitë respektive siç parashihet me nenin 18 të kësaj rregullore.

Në fakt, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas akt emërimit ka themeluar marrëdhënie punë sipas kategorisë profesionale, klasa profesional 2, me koeficient GJ36-4.95, ndërsa , Komuna e Rahovecit më datë 25.02.2026 ka miratuar Rregullorja me nr.01/102, për Organizmin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Rahovecit, mirëpo, ende nuk e ka përfunduar procesin e sistemit të stafit. Andaj, mbi këtë rrethanë faktike, konkretisht duke qenë se Komuna e Rahovecit është në procedurën e përfundimit të ristrukturimit të vendeve të punës, atëherë, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesi për klasifikimin e pozitës së tij nga klasa profesional 2 në kategorisë Specialist është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore, e për rrjedhojë, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit respektivisht procesit të ristrukturimit, sipas procedurës se theksuar më lartë, ankuesi nëse është i pakënaqur me këtë proces, do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.137/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit B.S;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.